



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 738/5 Prot.

Tiranë, më 29 / 07 / 2019

V E N D I M

Nr. 101, Datë 29 / 07 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 47, datë 16.05.2019, e Sh.M¹ kundër Shkollës 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit”, Tiranë dhe mësueses kujdestare F.C, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes shëndetësore”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Diskriminimi i djalit të saj për gjendjen shëndetësore, ka filluar në klasën kur fëmija filloi të kishte mësuese kujdestare, F.C. Përsëri diskriminimi vazhdon dhe sot që është nxënës në klasën. Mësuesja kujdestare ankohet shpeshherë që E.M i prish orën e mësimin dhe nuk tregon mirësjellje me nxënësit. Mësuesja ka lexuar në prani të të gjithë klasës diagnozën e djalit dhe kjo gjë nuk ka reaguar mirë në shëndetin e tij duke filluar acarimet në shtëpi dhe duke u bërë më shumë agresiv duke humbur dhe dëshirën për të shkuar në shkollë. Çdo gabim që fëmija bën në klasë mësuesja e qorton dhe e ka goditur duke mos marr parasysh gjendjen e fëmijës. Prindi i është drejtuar me ankesa të vazhdueshme, Drejtorit të shkollës për gjendjen e djalit dhe përgjigja e tij ka qenë: “Nuk jemi dakord me akuzat për ushtrim dhune, nuk i kemi të vërtetuara këto thënie”. Drejtori është shprehur që psikologjia e shkollës ka bërë informimet përkatëse, mësueses kujdestare si dhe ka përgatitur plane edukative, ndërkohë që ky informacion nuk është i vërtetë, sepse stafi i mësuesve nuk reagon pozitivisht me djalin e saj. Drejtori i shkollës i ka thënë, që si prindër duhet të bashkëpunojnë dhe duhet të ndikojnë në sjelljen e djalit të tyre, ndërkohë që gjithë agresiviteti i fëmijës, lind si pasojë e sjelljes së mësuesve. Si prind i ka dërguar ankesa DAR-it Tiranë për situatën por nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare, vetëm i*

¹ Në cilësinë e prindit të fëmijës E.M.

Referuar dokumentit, Përgjigje Rekomandimi, datë 27.03.2019 të QSUT, E.M është i diagnostikuar me çrregullim i hiperaktivitetit.

kanë thënë që nuk ka ardhur letër, por ishin në dijeni, sepse drejtori i shkollës, i kishte dërguar mesazh në lidhje me problemin dhe që djali kishte qëlluar një mësuese. Në nëntor 2017 është zhvilluar një mbledhje ku kanë qenë prezent, prindër me nxënës, bordi i klasës, mësuesit dhe drejtori i shkollës. Qëllimi i kësaj mbledhje ishte që ata si prindër të shoqëronim djalin gjatë orëve të mësimit ose të gjenim një mësues që ta paguanin vetë për mbikëqyrjen e djalit. Si prind ka tentuar që në ditët në vazhdim të shoqëronte djalin në orët mësimore, por mësuesja e fizikës nuk e ka lënë që të qëndronte në klasë. Më pas vajta e djalit në shkollë është rralluar për shkak të situatave. Ankuesja shprehet se Drejtori i shkollës i ka kërkuar një deklaratë, në të cilën të shprehte përgjegjësinë e saj si prind që ta lejonin, nëse fëmija kërkonte të largohej nga shkolla”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe mbështetjen e fëmijës me mësues ndihmës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 47, datë 16.05.2019, të Sh.M u konstatua se, ankuesja është vënë në dijeni për veprimet dhe sjelljet diskriminuese nga ana e drejtorit të shkollës dhe mësueses kujdestare në drejtim të djalit të saj që në vitin shkollor 2016-2017.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja e dëmtuarit, për këtë fakt”*, këto pretendime të ankesës nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk do t’i nënshtrohen procedurave të mëtejshme të shqyrtimit. Për sa më sipër, objekt i shqyrtimit të kësaj ankese do jenë pretendimet e subjektit ankues për veprimet e Drejtorit të shkollës dhe mësueses kujdestare për periudhën e vitit shkollor 2018-2019. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 738/1, datë 22.05.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Shkolla 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit” për ankesën e bërë nga Sh.M si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituarat:
 - Informacion nëse është ngritur Komisioni i shkollës për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe kopje të aktit administrativ për krijimin e këtij Komisioni.
 - Kopje të vlerësimit të nxënësit E.M nga Komisioni i shkollës për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe të vlerësimit të psikologut të shkollës.
 - Informacion nëse për këtë nxënës është hartuar Program Individual Edukativ i posaçëm. Nëse po, një kopje të këtij PEI-je.
 - Informacion se si është trajtuar kërkesa e ankueses për caktimin e mësuesit ndihmës dhe kopje të kërkesës për mësues ndihmës drejtuar DAR-it.

Me shkresën nr. 1067, datë 03.06.2019, Shkolla 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit” në mes të tjerash informoi se: *“Për vitin shkollor 2018-2019 nga prindërit e fëmijës E.M dhe nga vetë fëmija nuk ka ardhur asnjë ankesë kundër shkollës dhe mësueses kujdestare të klasës, F.C. Në fillim të këtij viti shkollor, me kërkesë të prindit, nxënësi E.M mund të qëndronte në klasë për aq kohë sa të ndihej mirë dhe mund të largohej para kohe për në shtëpi, me kërkesë të nxënësit dhe me dënimin e prindit. Nxënësi ka qenë i lirshëm të qëndronte në shkollë sa kohë të dëshironte, pa e kufizuar që të qëndronte në orë të plota mësimore ditore, dhe ashtu ka vazhduar gjatë gjithë kohës për këtë vit shkollor. Ndaj nxënësit nuk është ushtruar asnjë lloj dhune e çdo forme, qoftë nga stafi pedagogjik dhe as nga nxënësit. Çdo ankesë apo vërejtje nga nxënësi apo prindërit e tij nuk qëndrojnë dhe nuk janë të vërteta. Nga ana e shkollës, nuk mund të pranohen insinuata të tilla, tani në mes të muajit maj, kur nuk është bërë asnjë ankesë, nuk ka ardhur asnjë shqetësim nga prindërit gjatë gjithë vitit shkollor. Prindërit e nxënësit nuk janë paraqitur asnjëherë në shkollë, vetëm në datë 04.10.2018, kur është bërë deklarata për mbështetje nga ana e prindit të nxënësit. Drejtori i shkollës deklaroi se, nuk ka ndodhur asnjë me nxënësin E.M nga fillimi i vitit shkollor 2018-2019 e deri më sot. Për vitin shkollor 2018-2019 në shkollë është ngritur Komisioni për nxënësit me AK. Në këtë komision pasqyrohen nxënësit e rinj dhe ata ekzistues me AK, si dhe planet PEI, të rekomanduar dhe nga Komisioni i ZVA Tiranë. Vlerësimi i psikologes së shkollës përmbledh një informacion të plotë të marrë nga mësuesja kujdestare, mësuesit e lëndës, mësueset ndihmëse, vëzhgimet, bisedat me prindërit dhe takimet me nxënësin. Ky vlerësim i është paraqitur dhe Komisionit të AK në ZVA Tiranë dhe është miratuar prej tyre. Në shtator 2018, shkolla, ka dërguar në ZVA Tiranë, kërkesë për të patur nga një mësues ndihmës*

për çdo nxënës me AK, për shkak të numrit të madh të nxënësve me aftësi ndryshe. Janë emëruar dy mësuese ndihmëse për 12 nxënës me nevoja të veçanta, kështu që, duke mos e pasur mundësinë e ardhjes së mësuesve të tjerë ndihmës, shkolla është përpjekur të rregullojë orët sipas nevojave të këtyre nxënësve”.

Lidhur me pretendimet e prindit të nxënësit E.M, mësuesesja kujdestare, F.C, në mes të tjerash informoi se: *“Ankimimet për vitin shkollor 2017-2018 janë vërtetuar të pavërteta. Në asnjë moment dhe orë mësimore, nxënësi E.M nuk është diferencuar dhe përjashtuar nga procesi mësimor, ka punuar me shokët duke dhënë përgjigje të sakta në lexim, pasi nxënësi shkruan, flet dhe shprehet shumë mirë. Nxënësi paraqitet në shkollë rregullisht, por largohet nga shkolla me dijeni të prindit, për shkak të lodhjes së shpejtë”.*

Me shkresën nr. 47/1, datë 06.06.2019, Zyra Vendore Arsimore Tiranë, parashtroi dhe njëherë përgjigjen e dhënë nga drejtoria e shkollës 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit”, si dhe vuri në dispozicion të Komisionerit, kopje të Rekomandimit³ të dhënë nga Komisioni Multidisiplinar i DAR, Tiranë për nxënësin EM, në të cilin ka rekomanduar asistimin e nxënësit nga mësues ndihmës, me 2 orë në ditë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me pretendimin e ankueses për trajtim të disfavourshëm të djalit të saj për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore.

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare. Ky legjislacion u ngarkon detyra të rëndësishme njërive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëllor si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t’i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme. Nën këtë frymë konsiston edhe përmbajtja e nenit 63, pika 2 e ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku parashikohet: *“Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”.*

“Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuar, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të

³ Rekomandim nr. Extra, datë 24.09.2018.

barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një mbrojtje e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të siguruar që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë.

Në këtë kuadër, legjislacioni shqiptar u ngarkon detyra të rëndësishme njësisive arsimore vendore dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëllor si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t'i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme.

Në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të integrohen në institucionet arsimore të zakonshme është e nevojshme, sipas vlerësimeve të bëra nga Komisioni Multidisiplinar i DAR/ZA që ata të asistohen nga mësuesit ndihmës. Neni 65 i ligjit të sipërpërmendur parashikon shprehimisht: *“Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit.”*.

Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencave, “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar” është një akt nënligjor që merr përsipër të parashikojë më hollësisht procedurat dhe të përcaktojë detyrat konkrete që u ngarkohen njësisive arsimore vendore dhe institucioneve arsimore, lidhur me trajtimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Neni 97, pika 1, i Urdhërit të sipërpërmendur parashikon: *“Sipas normës së përcaktuar nga ministri dhe vlerësimit nga Komisioni pranë DAR/ZA-së, në klasat e zakonshme që kanë edhe fëmijë me AK, punojnë mësues ndihmës.....”*.

Për sa më sipër, rezulton se mësuesi ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara caktohet në bazë të vlerësimit të Komisionit Multidisiplinar të DAR/ZA. Në këtë kontakt, duhet theksuar fakti se Komisioni Multidisiplinar i DAR Tiranë ka dhënë vlerësimin e tij për caktimin e mësuesit ndihmës për nxënësin E.M, për të cilën është caktuar norma 2 orë mësimore në ditë.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se drejtuesit e shkollës 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit”, kanë ndjekur procedurat⁴ për asistimin e nxënësit E.M me mësues ndihmës. Po ashtu në zbatim të legjislacionit të sipërcituar drejtuesit e shkollës 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit” kanë ngritur Komisionin e Shkollës⁵ për evidentimin e fëmijëve me

⁴ Referuar shkresës nr. 915, datë 14.09.2018 të drejtorisë së shkollës, drejtuar DAR Tiranë, në të cilën kërkohet mësues ndihmës për 10 nxënës të shkollës.

⁵ Shkresa datë 19.09.2018 e Shkollës “Lidhja e Prizrenit”.

aftësi të kufizuara, si dhe mësuesja kujdestare dhe mësuesit ndihmës kanë hartuar Planin Edukativ Individual⁶ me të cilin është punuar me nxënësin E.M.

Gjithashtu, referuar shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezultoi se gjatë vitit shkollor 2018-2019, nuk ka patur mosmarrëveshje apo pretendime mes drejtuesve të shkollës, personelit mësimor dhe prindërve të nxënësit E.M.

Pavarësisht se gjatë këtij viti mësimor nuk ka patur mosmarrëveshje mes palëve, Komisioneri është vënë në dijeni, se nxënësi E.M, nuk ka frekuentuar rregullisht shkollën për shkak të gjendjes emocionale të tij dhe mospasjes së ndihmës apo mbështetjes gjatë gjithë procesit mësimor të mësueses ndihmëse, pasi dhe rekomandimi i Komisionit Multidisiplinar të DAR-it është asistimi me mësues ndihmës, me vetëm 2 orë mësimore në ditë.

Lidhur me këtë, Komisioneri sugjeron që prindi i nxënësit E.M, i asistuar nga drejtori i shkollës të depozitohet një kërkesë me shkrim pranë Komisionit Multidisiplinar, të ZVA Tiranë në të cilën të kërkojë asistimin me mësues ndihmës me më shumë se 2 orë në ditë për nxënësin E.M. Neni 93, pikat 3-4, të Urdhërit nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencave, “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar” parashikojnë se Komisioni Multidisiplinar, me kërkesën e prindit të fëmijës ose të drejtorit të institucionit arsimor, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij. Komisioni mblidhet 3 herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit mësimor. Drejtori i institucionit arsimor këshillohet me komisionin e institucionit arsimor para se t’i drejtohet komisionit pranë DAR/ZA-së dhe bashkëpunon me prindërit e fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, vlerësojmë se fëmija i Sh.M, nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga sa parashikohet në DN⁷ dhe ligjin për Arsimin

⁶ Plan Edukimi Individual për nxënësin E.M, datë 10.10.2018.

⁷ Shkurtesë për Dispozitat Normative të arsimit parauniversitar.

Parauniversitar përmes mos përfitimit të asistimit me mësues ndihmës në procesin e të nxënës në procesin mësimor.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 7/1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri vlerëson se Shkolla 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit” dhe mësuesja kujdestare F.C, nuk kanë ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj fëmijës së ankueses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson se, duke pasur parasysh parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtën e tyre për një edukim cilësor, Drejtoria e shkollës “Lidhja e Prizrenit” dhe prindi i fëmijës duhet të marrin masa, që duke filluar nga ky vit shkollor të bashkëpunojnë më mirë dhe të gjejnë mundësinë e frekuentimit të rregullt të mësimin nga ana e nxënësit E.M, dhe t’i kërkohet ZVA Tiranë, mbështetja me më shumë orë mësimore me mësues ndihmës për nxënësin E.M.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësit E.M nga ana e shkollës 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit” dhe mësueses kujdestare F.C për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore.
2. Rekomandohet depozitimi i një kërkesë me shkrim i prindërve të nxënësit E.M pranë Komisionit Multidisiplinar të ZVA Tiranë, për shtimin e orëve, përgjatë së cilave do të jepet shërbimi përkatës nga mësuesja ndihmëse për këtë nxënë, për vitin e ardhshëm mësimor.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e tij.

ROBERT GAJDA

KOMISIONER